



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. 01/01-15006 /2024
Dt. 20.09.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe nenin 40.2 shkronja (b) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 21 shkronja (b) të Statutit të Komunës së Gjakovës, 01 nr.110/04-29365 i datës 28.12.2022 në mbledhjen e mbajtur me datë 20.09.2024, pas diskutimit lidhur me pikën e 3 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Projekt Buxhetit të Komunës së Gjakovës për vitin 2025, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

Miratimin e Buxhetit të Komunës së Gjakovës për vitin 2025

1. Miratohet Buxheti i Komunës së Gjakovës për vitin 2025
2. Struktura e Buxhetit Komunal për vitin 2025 është si vijon:

- Paga dhe Mëditje	19, 297,938,00€
- Mallra dhe Shërbime	4, 670,000.00€
- Shpenzime Komunale	788,500.00€
- Subvencione dhe Transfere	1, 085,000.00€
- Investime Kapitale	14, 742,931.00€
Totali	40, 584,369.00€
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës, z. Ardian Gjini.
 - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
 - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.



Arbënësna Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	12/09/2024
Për:	Z. Arbënesha Kuqi – Kryesuese e Kuvendit Komunal
Përmes	Z. Ardian Gjini – Kryetari i Komunës së Gjakovës 
Nga:	Z. Durim Halilaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa 
Lënda:	Projekt Buxheti i Komunës së Gjakovës për periudhën: 2025 - 2027



Të nderuar,

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me qeverinë komunale konformë Qarkoreve buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave për komunat nr. 2025/01/02, ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ka përgatitur pakon e materialeve me tabelat përkatëse të Buxhetit të Komunës së Gjakovës për periudhën: 2025-2027 për shqyrtim dhe miratim.

Shpërndarja e Buxhetit Komunal për periudhën 2025 – 2027, siq shihet edhe në projekt buxhetin e bashkangjitur sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve është bërë konform limiteve buxhetore të përcaktuara në qarkoren e dytë buxhetore të lëshuar nga ana e MFPT-së.

Bashkangjitur me këtë shkresë gjeni:

- ❖ Projekt Buxhetin Komunal 2025 – 2027;
- ❖ Tabelën e kategorive buxhetore – tabelën kumulative 2025 - 2027;
- ❖ Tabelën e projekteve kapitale;
- ❖ Planifikimin e të hyrave vetanake;
- ❖ Buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Me respekt,
Z. Durim Halilaj
Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

KOMUNA E GJAKOVËS

Postal address: Nena Tereze Gjakove , Kosovë
Tel: +381 390 27 259 Fax: +381 390 27 259



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



PROJEKT BUXHETI I KOMUNËS SË GJAKOVËS

PËR VITIN 2025

Gjakovë, 2024

HYRJE

Korniza e përgjithshme

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025 – 2027 si dokument i rëndësishëm dhe më kryesor paraqet koherencën, koordinimin dhe ndërlidhjen funksionale në mes të prioritetëve të përcaktuara me dokumentet strategjike komunale për zhvillim në njërin anë si dhe përfshirjen e tyre konkrete e specifike në projeksionet buxhetore për periudhën afatmesme. Duke u bazuar në këto premisa themelore që përfshijnë aspektet e menaxhimit të financave publike, ato fiskale, ekonomike e shoqërore është konceptuar edhe Deklarata e Prioritetëve të Qeverisë komunale komfor Strategjisë komunale për zhvillim.

Prioritetet e Qeverisë Komunale të Gjakovës si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në nivel të Republikës së Kosovës: 2025 – 2027, janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, infrastrukturës komunale, sektorit të arsimit, kulturës, rinisë dhe sporteve, sektorin e shëndetësisë primare, atë të bujqësisë, mjedisit etj. Prioritetet afatmesme 2025 - 2027, bazohen në Programin e Punës së Qeverisë Komunale dhe prioritetet e saj dhe Strategjinë e Zhvillimit Socio – Ekonomik Lokal për këtë periudhë.

Me Qarkoren e parë buxhetore nr.2025/01, të datës 15.05.2024 të lëshuar nga ana e MF-, janë caktuar limitet buxhetore për Komuna për periudhën 3 vjeçare: 2025 – 2027 në mesin e të cilave edhe për Komunën e Gjakovës .

Në procesin e realizimit të prioritetëve të Qeverisë Komunale rëndësi e veçantë i kushtohet qëndrueshmërisë buxhetore dhe projeksioneve makro – fiskale për periudhën afatmesme. Në këtë drejtim do të punohet që të vazhdohet me ritmin e ngritjes së vazhdueshme të investimeve kapitale, pastaj të ruhet stabiliteti buxhetor, ngarkesë të ulët të biznesit me tatime si dhe rritja e nivelit të grumbullimit të hyrave vetanake.

Komuna e Gjakovës si mision të vetin ka zhvillimin më të shpejtuar ekonomik të saj sipas prioritetëve të Strategjisë Komunale për Zhvillim Ekonomik të Komunës, duke siguruar ambient të sigurt dhe tërheqës për investitorët. Do të inkurajojë, mbështesë, bashkërendojë dhe koordinojë me efikasitet politika, aktivitete e burime që i kontribuojnë prosperitetit e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të Komunës, fuqizimit të biznesit dhe sipërmarrjes, për një mirëqenie më të lartë njerëzore. Misioni i Qeverisë komunale për periudhën afatmesme buxhetore, është përsheptimi i ritmeve të zhvillimit ekonomik, shtimin e mundësive për shkollim, avancim të llojit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore, kulturën, rininë dhe sportin, lëmin e bujqësisë si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe infrastrukturës komunale si çështje më kryesore që mund të ndikojnë për përmirësimin e shpejtë të gjendjes ekonomike e shoqërore të banorëve të Komunës.

KORNIZA FISKALE

Ndonëse Komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Buxheti Komunal i Gjakovës është në përputhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës dhe me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Financimi komunal nga grantet qeveritare për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitin 2026 dhe 2027, përfshirë të hyrat vetanake komunale.

Nga aspekti i kornizës së re ligjore, sistemi i financimit komunal ka pësuar reforma progresive përkatësisht ndryshime të mëdha në vijën horizontale dhe vertikale të financimit. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2025 si dhe pjesëmarrja e buxhetit komunal në Buxhetin e Republikës së Kosovës, janë strukturuar në linjë me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Sistemi aktual i financave komunale përbën decentralizimin fiskal të avancuar, komunat kanë kompetenca të konsiderueshme për shpenzimet, kompetenca për ofrim të shërbimeve publike, autorizime për mbledhjen e të hyrave, dhe autoritet të gjerë në menaxhimin e financave publike.

Përkushtimi i përgjithshëm për të përmirësuar elementet kyçe të procesit të zhvillimit të buxhetit, ka kërkuar edhe disa ndryshime në formatin e prezantimit të buxhetit komunal. Prandaj, jemi mbështetur në aspektet kryesore të mëposhtme të procesit buxhetor:

- Shfrytëzimi i Buxhetimit në nivel të programit dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të regjistrit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxheti mit të orientuar drejt rezultateve; dhe
- Zbatimi i konceptit mbi planifikimin shumëvjeçar të buxhetit / kapitaleve dhe prezantimi i të gjitha zërave të buxhetit për vitin paraprak, vitin e tanishëm buxhetor dhe për dy vitet pasuese.

Futja në përdorim e Buxhetimit kapital shumëvjeçar, përfshirë këtu integrimin e informatave për rezultatet e planifikuara në sistemin e PIP-it. Gjatë këtij viti komunat do të hartojnë për secilin program strategjinë me synimet dhe objektivat, përfundimet dhe rezultatet që synohen të arrihen përmes procesit buxhetor.

PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE

Sipas Qarkores së dytë buxhetore nr.2025/02 për Komuna të datës 14.08.2024 dhe në bazë të shënimeve statistikore të regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës të vitit 2011, rrjedhë se komuna e Gjakovës ka 94,556 banorë, dhe nga Komisioni i Granteve – MF për vitin 2025 Komunës sonë iu është ndarë Grant Qeveritar 40,584,369.00 €.

Tabela nr. 1. Krahassimi i Buxhetit 2024/2025

Nr.	Përshkrimi	Vlera
	Buxheti komunal 2024 (aktual)	37,483,964.00
	Buxheti i propozuar 2025	40,584,369.00
	Ndryshimi	+ 3,100,405.00

Burimi: Qarkorja Buxhetore 2025/02, MF 2024

BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2025

Bazuar në tabelat e buxhetit komunal nga vitet e kaluara dhe me qëllim të vazhdimit të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal për vitin 2025 është planifikuar dhe pasqyrohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nën-programeve buxhetore. Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Prioritet për financim kanë projektet që janë të vazhdueshme që kanë filluar në vitet e mëparshme dhe atyre që janë në harmoni me prioritetet e Komunës.

Burimet e financimit komunal për vitin 2025

Financimi komunal përfshinë: grantet specifike operative për arsim para universitar dhe shëndetësi primare, grantet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opsion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në LMFP të dakorduar me Misionin e FMN-së.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.


Sipas Qarkores se parë dhe te dyte buxhetore të lëshuar nga ana e MF-it për periudhën 2025-2027 për Komunën e Gjakovës është caktuar për financimin e shpenzimeve 3 vjeçare si në tabelën 2.

Tabela nr.2. Totali i Burimeve të financimit komunal për vitet: **2024-2027**

Kategoritë BUXHETORE - Burimet e financimit		2024	2025	2026	2027
		Aktual	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
1	Granti i Përgjithshëm	14,762,483.00	15,956,892.00	16,890,154.00	17,840,435.00
2	Granti specifik i Arsimit	12,909,004.00	13,164,769.00	13,559,712.00	13,966,504.00
3	Granti specifik i Shëndetësisë	4,454,553.00	4,869,365.00	5,101,147.00	5,343,962.00
	Financimi për shërbimet rezidenciale(SHKPM)		150,000.000	200,000.00	200,000.00
	Financimi për shërbimet rezidenciale(SHKPAK)		(230,000.00)	(200,000.00)	(200,000.00)
	Financimi për shërbimet rezidenciale(SHEMF)		230,000.00	210,000.00	210,000.00
4	Të hyrat vetanake komunale	5,091,658.00	5,934,237.00	6,406,561.00	6,887,230.00
5	Financimi për teatro	266,266.00	279,104.00	294,454.00	310,649.00
TOTALI:		37,483,964.00	40,584,367.00	42,662,028.00	44,758,780.00


Burimi: Qarkorja Buxhetore 2025/02, MF 2024

Grafiku i trendit të buxhetit komunal 2024-2027



Burimi: Qarkorja Buxhetore 2025/02, MF 2024

Grafiku i buxhetit komunal sipas burimeve të financimit 2024-2027



Burimi: Qarkorja Buxhetore 2025/01, MF 2024

Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2025-2027

Përveç Granteve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e mbulimit të shpenzimeve të përgjithshme, Komuna mbledh edhe të hyra vetanake. Të hyrat vetanake në Komunën e Gjakovës realizohen në bazë të Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Me Qarkoren buxhetore nr. 2025/01, për komunën e Gjakovës, për vitet: 2025 – 2027 është përcaktuar Planin i të hyrave vetanake si vijon:

- Viti 2025 5,934,237.00 €,
- Viti 2026 6,406,561.00 €,
- Viti 2027 6,887,230.00 €.

Parashikimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën 2021-2023

Për të pasur një pasqyrë mbi shpenzimet buxhetore të Komunës së Gjakovës sipas kategorive ekonomike buxhetore, në tabelën vijuese po paraqesim trendët historike të shpenzimeve për periudhën e dy viteve të kaluara 2022, 2023, dhe buxhetin aktual 2024, me ç'rast mund të shihen shumat e mjeteve të shpenzuara buxhetore sipas destinimeve dhe pozicioneve buxhetore.

Tabela 4. Trendët historike të financimit sipas strukturës ekonomike për Komunën e Gjakovës 2022-2024.

	Komuna e Gjakovës	2022 (Shpenzuar)	2023 (Shpenzuar)	2024 Aktual (Aprovuar)
1	Paga dhe mëditje.	14,345,540.52	18,295,920.24	18,843,800.00
2	Mallra dhe shërbime	3,858,971.54	4,136,946.14	4,337,556.00
3	Shpenzime komunale	565,967.56	687,330.33	680,000.00
4	Subvencione dhe transfero	613,999.98	695,218.70	980,000.00
5	Shpenzime kapitale	7,499,060.33	14,071,833.82	12,642,608.00
	Totali :	26,883,539.93	37,887,249.23	37,483,964.00
	Numri i stafit	2252	2252	2250

Propozimi i financimit të Komunës së Gjakovës sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për periudhën: 2025 – 2027 është si në tabelën 5.

Tabela 5. Kufijtë e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të vlerësuara për Financim për Komunën e Gjakovës: 2025– 2027

	Komuna e Gjakovës	2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	19,297,938.00	20,359,324.00	21,438,368.00
2	Mallra dhe shërbime	4,670,000.00	4,763,400.00	4,858,668.00
3	Shpenzime komunale	788,500.00	823,983.00	865,182.00
4	Subvencione dhe transfere	1,085,000.00	1,139,250.00	1,230,390.00
5	Shpenzime kapitale	14,742,931.00	15,576,072.00	16,366,172.00
	Totali :	40,584,369.00	42,662,029.00	44,758,780.00
	Numri i stafit	2285	2285	2285

SQARIM - Shpërndarja e Buxhetit komunal për periudhën : 2025 – 2027, siç shihet edhe në tabelën e lartshënuar, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, është bërë konform limiteve buxhetore të përcaktuara me Qarkoren e dytë buxhetore 2025/02, të datës 14.08.2024 të lëshuar nga ana e MF-ja.


Struktura e Buxhetit për vitin 2025

Paga dhe mëditje	19,297,938.00	47.55%
Mallra dhe shërbime	4,670,000.00	11.51%
Shpenzime komunale	788,500.00	1.94%
Subvencione	1,085,000.00	2.67%
Investime kapitale	14,742,931.00	36.33%
TOTALI	40,584,369.00	100.00%

Diagrami strukturës së buxhetit për vitin 2025

Më poshtë janë të prezantuara tabelat buxhetore 4.1, 4.2, Tabela kumulative e buxhetit me kufijtë përfundimtar të programeve buxhetore, Plani i të hyrave vetanake komunal, dhe Buxhetimi i Përgjegjshëm Buxhetor.

Stuktura e buxhetit për vitin 2025



Gjakovë, Shtator 2024

Drejtorja për Buxhet dhe Financa



KOMUNA E GJAKOVËS

Lista e projekteve kapitale të propozuara për periudhën 2025 - 2027

Nr.	Emri i projektit	Projeksionet	Projeksionet	Projeksionet
		2025	2026	2027
	TOTALI I BUXHETIT PËR INVESTIMET KAPITALE	14,742,931.00	15,576,072.00	16,366,172.00
	2025 - 2027			
	Buxhet dhe Financa	404,119.00	666,072.00	6,776,172.00
1	Projektet e ndryshme kapitale me bashkëfinancim	404,119.00	666,072.00	6,776,172.00
	Infrastruktura Publike	710,000.00	600,000.00	600,000.00
1	Sanimi dhe ndërtimi i parqeve -Qerim,Piskot,Berkoc,Blloku I ri,Has, ,Reka e keqe	250,000.00	250,000.00	250,000.00
2	Rehabilitimi i ujrave të zeza dhe atmosferike në Qytet -Reka e Mirë, Reka e Keqe	100,000.00	100,000.00	100,000.00
3	Ndërtimi i parkut "Xhubleta"	60,000.00		
4	Zgjerimi i linjes së ndriqimit publik në Piskot,Berkoc,Qerim Blloku I ri,Has, ,Reka e	250,000.00	250,000.00	250,000.00
5	Ndërtimi i parkut dhe lodrave për fëmijë në rrugën "Gazmend Ymeri" (buxhetim	50,000.00		
	Infrastruktura Rrugore	8,957,812.00	10,320,000.00	5,530,000.00
1	Rehabilitimi i rrugëve me asfalt Qerim,Piskot,Berkoc,Blloku I ri,Has, ,Reka e keqe	300,000.00	300,000.00	500,000.00
2	Pajimet dhe Sinjalizimi i trafikut rrugorë në -Reka e keqe ,Reka e mirë, Dushkaj, H	100,000.00	80,000.00	80,000.00
3	Ndërtimi dhe sanimi i Urave në Has,Rekë e mirë, Rekë e Keqe,në Dushkaj	50,000.00	50,000.00	50,000.00
4	Ndërtimi - Sanimi i rrugëve dhe trotuareve me kubëza në Berkoc,Piskotë, Qerim,	200,000.00	250,000.00	300,000.00
5	Ndërtimi dhe asfaltimi i Rrugës Goden - Zylfaj - Prush		100,000.00	200,000.00
6	Ndërtimi i rrugës Dalja për Peje - Pjesë e Qarkores së Qytetit	500,000.00		
7	Ndërtimi i Rruges në Rezinë	100,000.00	100,000.00	100,000.00
8	Rregullimi i shtratit të Lumit Krena	630,000.00		
9	Rregullimi i shtratit të Lumit Krena faza finale	500,000.00	1,000,000.00	
10	Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit	3,000,000.00	3,000,000.00	
11	Ndërtimi i shtratit të lumit "Llukac"	500,000.00	500,000.00	500,000.00
12	Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Firzë, Bërkoc	67,812.00		
13	Ndërtimi rrugëve Sylejman Hadum Aga dhe Ismajl Qemajli	250,000.00		
14	Ndërtimi - asfaltimi i rrugës "Skenderbeu"		200,000.00	200,000.00
15	Ndërtimi - asfaltimi i rrugës "Ganimete Terbeshi"		200,000.00	200,000.00
16	Ndërtimi - asfaltimi i rrugës "Lagjia Gece"		200,000.00	250,000.00
17	Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatin Meqë	100,000.00	100,000.00	
18	Rregullimi i shtratit të Lumit Gusha, Botushë	50,000.00	40,000.00	
19	Ndërtimi i infrastruktures në Liqenin Erenik	400,000.00	1,700,000.00	2,000,000.00
20	Ndërtimi Asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Bishtrazhin	100,000.00	100,000.00	
21	Ndërtimi Asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Rogove	100,000.00	70,000.00	
22	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Demjan	100,000.00	70,000.00	
23	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Dol	100,000.00	70,000.00	
24	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në Gerqin, Lipovec	100,000.00	100,000.00	
25	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve tek pika e zezë	100,000.00	100,000.00	
26	Ndërtimi rristrokturimi i rrugës Kralan Rakovin	200,000.00	300,000.00	150,000.00
27	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Bec	100,000.00	70,000.00	
28	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Cermjan	100,000.00	70,000.00	
29	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në fshatrat Doblibare, Rezinë, Berdosane	80,000.00	70,000.00	
30	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve Nec Korenic Meje Jahoc	100,000.00	80,000.00	
31	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Ramoc	100,000.00	100,000.00	
32	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në Babaj Bokes	100,000.00	80,000.00	
33	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Molliq	70,000.00	70,000.00	
34	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në Shishmon	60,000.00		
35	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në Hereq ,Dujak	100,000.00	70,000.00	
36	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Skivjan	100,000.00	100,000.00	
37	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Novosell	100,000.00	100,000.00	
38	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në Piskot	80,000.00	100,000.00	
39	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Sheremetaj	70,000.00	100,000.00	
40	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Gërgoc	70,000.00	20,000.00	
41	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në Moglic Firze	60,000.00	60,000.00	
42	Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në bashkësin lokale Berkoc	70,000.00	100,000.00	
43	Ndërtimi asfaltimi i rrugës Lugbunar	50,000.00	100,000.00	
44	Ndërtimi - Asfaltimi i rrugës "Maja Kunores"		400,000.00	1,000,000.00
	Zjarrfikësit	-	270,000.00	250,000.00
1	Furnizimi me autocistern për brigaden zjarrfikës, kapaciteti 8,000 litra		270,000.00	
2	Furnizimi me autocistern për brigaden zjarrfikës, kapaciteti 4,000 litra			250,000.00

	Bujqësia	450,000.00	500,000.00	520,000.00
1	Ndërtimi i Kanaleve të ujitjes në Has,Rekë e mire ,Reka e keqe	250,000.00	250,000.00	270,000.00
2	Sanimi i Pendave dhe kanaleve te ujitjes ne rajonet Has,Reke e keqe,Reka e mirë	100,000.00	120,000.00	120,000.00
3	Ndërtimi - Rregullimi i rrugeve fushore në rajonet Has,Rekë e mire ,Reka e keqe d	100,000.00	130,000.00	130,000.00
	Zhvillimi Ekonomik	700,000.00	450,000.00	250,000.00
1	Ndërtimi i Qendrës së Biznesit në Gjakovë	200,000.00	150,000.00	
2	Ndërtimi i shtegut dhe Shkugëza e Sfidave	100,000.00	100,000.00	
3	Ndërtimi I shtegut për ecje Cermjan Palabardh		50,000.00	100,000.00
4	Ndërtimi I Shtegut rreth liqenit të Radoniqit		50,000.00	150,000.00
5	Ndërtimi I ures kembesore tek Ura e fshejte	400,000.00	100,000.00	
	Kadastra dhe Gjeodezia	1,500,000.00	1,200,000.00	1,000,000.00
1	Ndërtimi i Qarkorës së Qytetit	1,500,000.00	1,200,000.00	1,000,000.00
	Shëndetësia - Shëndetësia Primare	290,000.00	220,000.00	20,000.00
1	Renovimi i QKMF 1, Orize Dardani Erenikë	100,000.00	170,000.00	
2	Ndërtimi i objektit për banim social	190,000.00		
3	Rrethimi I oborrit dhe rregullimit te banimit social		50,000.00	20,000.00
	Shërbimet Sociale	190,000.00	-	-
1	Renovimi I objekteve ekzistuese të banimit social	190,000.00		
	Shërbimet Rezidenciale	430,000.00	410,000.00	410,000.00
1	Ndërtimi I shtëpisë për persona të moshuar në Gjakovë	200,000.00	200,000.00	200,000.00
2	Financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve	230,000.00	210,000.00	210,000.00
	Kultura, Rinia dhe Sportet - Shërbimet Kulturore	386,000.00	210,000.00	250,000.00
1	Instalimi i Kamerave në Objektet e DKRS		60,000.00	
2	Renovimi & Rrethojat në Palestren e Sporteve			150,000.00
3	Ndërtimi I Terreneve dhe Këndeve Rekreative		100,000.00	100,000.00
4	Ngrohja,Klimatizim Muzeu Etnografik	76,000.00		
5	Renovimi I Muzeut Etnografik dhe Historik	20,000.00		
6	Rindërtimi i Mejtepit Ruzhdi	150,000.00	50,000.00	
7	Ndërtimi i tereneve sportive ne Rogove (buxhetim me pjesemarrje)	50,000.00		
8	Ndërtimi i parkut rekreativ sportiv dhe amfiteatri veror ne Korenice (buxhetim m	50,000.00		
9	Ndërtimi I mekanizmit të Sahat Kullës	40,000.00		
	Kultura, Rinia dhe Sportet - Rinia	10,000.00	200,000.00	-
1	Rivitalizimi i Qendrave Rinore	10,000.00	200,000.00	
	Arsimi	715,000.00	530,000.00	760,000.00
1	Renovime dhe adaptime te objekteve shkollore:Gj. H.Dushi Gjakovë,Z. RexhaGjak	250,000.00	400,000.00	700,000.00
2	Blerja e makinave për pastrimin e dysHEMEVE në shkolla	30,000.00	30,000.00	30,000.00
3	Blerja e pajisjeve ne shkollat profesionale në shk.e Mesme H.Zajmi-laboratori mje	32,000.00	30,000.00	30,000.00
4	Renovimi dhe adaptimi i shkollës "Z.L.Marku" Brekoc	48,000.00		
5	Ndërtimi i qerdhes në Rogovë	129,000.00		
6	Ndërtimi I kalldajave dhe paisjeve tjera të ngrohjeve qendrore në shkolla	20,000.00		
7	Renovimi dhe adaptimi i shkollës "H.Hoti" Rogovë	180,000.00	70,000.00	
8	Blerja e paisjeve muzikore në shk. e muzikes Prenk Jakova	10,000.00		
9	Blerja e gjeneratorëve për shkolla	6,000.00		
10	Blerja e makines korrese se barit dhe blerja e kazanit dhe elementeve percjellese	10,000.00		

Shtator 2024



KOMUNA E GJAKOVËS

Kodet	BURIMI I TË ARDHURAVE	2025 Planifikim	2026 Planifikimi	2027 Planifikim
1	Administrata e përgjithshme	150,000.00	161,938.00	174,089.00
50013	Certifikatat e lindjes	90,000	97,163.00	104,453.00
50014	Certifikatat e kurorëzimit	20,000	21,592.00	23,212.00
50015	Certifikatat e vdekjes	6,500	7,017.00	7,544.00
50016	Certifikatat e tjera	10,000	10,796.00	11,606.00
50017	Taksa të verifikimit të dokumenteve të ndryshme	23,500	25,370.00	27,274.00
	Taksa administrative të ndryshme	-	-	-
	Prokurimi -Të hyrat nga Shpallja e tendereve	-	-	-
2	Drejtoria e Inspeksionit	110,000.00	126,714.00	143,724.00
50505	Inspektimi veterinar brenda vendit	-	-	-
50507	Leje për plotësimin e kushteve sanitare teknike	80,000.00	86,367.00	92,847.00
50104	Gjobat nga inspektoriat	30,000.00	40,347.00	50,877.00
50019	Taksa administrative pijeve alkooolike	-	-	-
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3,175,183.00	3,517,136.00	3,866,169.00
50408	Qiraja për lokalet e komunës	100,000.00	106,367.00	118,847.00
40110	Tatimi mbi pronën dhe tokë	2,865,183.00	3,184,054.00	3,503,598.00
50001	Taksa për regjistrimin e automjeteve	210,000.00	226,715.00	243,724.00
4	Drejtoria e Shërbimeve Publike	111,500.00	120,375.00	129,406.00
50103	Sekuestrimi i automjeteve	500.00	540.00	580.00
50008	Të hyrat nga parkingjet	75,000.00	80,969.00	87,044.00
50005	Taksa për leje vozitje - autobusëve	10,000.00	10,796.00	11,606.00
50406	Të hyrat nga tregjet	23,000.00	24,831.00	26,694.00
50401	Shitja e makinave	1,000.00	1,080.00	1,161.00
	te hyrat nga kompenzimi i demve te aseteve rrugo	2,000.00	2,159.00	2,321.00
5	Drejtoria e Agrikulturës	95,000.00	102,561.00	110,256.00
50012	Shndërrimi i tokës bujqësore ne jo - bujqësore	95,000.00	102,561.00	110,256.00
	Shitja e drunjteve te konfiskuar	-	-	-
6	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	245,000.00	256,541.00	268,286.00
50204	Leje - Taksa mbi firmën e biznesit	230,000.00	240,347.00	250,877.00
50221	Leje - Taksa për zgjatjen e orarit te punës	15,000.00	16,194.00	17,409.00
7	Kadastra	250,000.00	269,898.00	290,148.00
50504	Të hyrat nga shërbimet kadastrale	250,000.00	269,898.00	290,148.00
50503	Të hyrat nga Ekspertiza	-	-	-
8	Drejtoria e Urbanizmit	1,314,554.00	1,366,806.00	1,418,941.00

Tabela 4.3. Plani Aftamesëm i të hyrave totale komunale

Të Hyrat Vetanake	2025 Planifikim	2026 Planifikim	2027 Planifikim
Tatimi në pronë	2,865,183	3,184,054	3,503,598
Taksat Komunale	58,858	63,543	68,310
Licencat dhe Lejet	335,000	353,704	372,739
Certifikatat dhe Dokumentet Zyrtare	150,000	161,938	174,089
Taksat e paisjeve motorike	210,000	226,715	243,724
Lejet për ndërtesa	1,225,696	1,270,875	1,315,813
Taksat tjera Komunale			
Ngarkesat Komunale	30,000	40,347	50,877
Ngarkesat rregullatore	500	540	580
Të hyrat nga qiraja	198,000	212,167	232,585
Bashkë pagesat për Arsime	363,000	363,000	363,000
Bashkë pagesat për Shëndetësi	100,000	100,000	100,000
Ngarkesat tjera komunale			
Të hyrat tjera	398,000	429,678	461,916
TOTAL THV	5,934,237	6,406,561	6,887,231

50009	Lejet e ndërtimit - (Taksa administrative dhe Tarifa rregullative për rritjen e densitetit)	1,225,696.00	1,270,875.00	1,315,813.00
50011	Taksat komunale: Pëlqimet e ndryshme, ndarjet fizike, ekstraktet nga planet, lejet dhe pëlqimet për objektet e infrastrukturës dhe taksa nga leja mjedisore)	48,858.00	52,747.00	56,704.00
50405	Kompensimi për shfrytëzimin e hapësirës publike: (Kompensimi për objektet montuese- de montuese, për panot reklamuese dhe për hapësirat publike)	30,000.00	32,388.00	34,818.00
50408	Qiraja: (Qiraja për shfrytëzimin e banesave nga programi i banimit social)	-	-	-
	Propozim - Taksat komunale nga trajtimi i ndërtimeve pa Leje – legalizimi i objekteve	10,000.00	10,796.00	11,606.00
9	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	20,000.00	21,592.00	23,212.00
	Të hyrat nga kultura, rinia dhe sportet	20,000.00	21,592.00	23,212.00
	Dënimet në trafik-direkt nga MF-i			
	Te hyrat nga Gjykata			
	Të hyrat nga Pyjet			
I.	TOTALI I ADMINISTRATES KOMUNALE	5,471,237.00	5,943,561.00	6,424,231.00
II.	ARSIMI	363,000.00	363,000.00	363,000.00
III.	SHENDETËSIA	100,000.00	100,000.00	100,000.00
	SUB TOTALI I + II + III	5,934,237.00	6,406,561.00	6,887,231.00
IV.	Participimet e qytetarëve dhe të hyrat tjera etj.			
	SUB TOTALI I + II + III+IV+V	5,934,237.00	6,406,561.00	6,887,231.00

5,934,237.00 6,406,561.00 6,887,231.00

2,865,183.00

3,184,054.00

3,503,598.00



Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2025

Kodi	Programet	Nr. Pun	Paga dhe Meditje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	16	136,557.00	100,000.00		320,000.00		556,557.00
163/16316	Aministrata dhe Perso	56	395,077.00	520,000.00	70,000.00			985,077.00
166/16631	Inspektimet	23	238,126.00	120,000.00				358,126.00
167/16780	Prokurimi	6	52,450.00	10,000.00				62,450.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Komu	39	317,640.00	30,000.00				347,640.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	30	223,619.00	55,682.00			404,119.00	683,420.00
180/18176	Infrastruktura Publike	7	62,596.00	1,100,000.00	220,000.00	10,000.00	710,000.00	2,102,596.00
180/18016	Infrastruktura Rrugor	8	71,660.00	150,000.00			8,957,812.00	9,179,472.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspe	55	411,371.00	100,000.00	20,000.00			531,371.00
195/19580	Zyra Komunale për Kc	4	32,765.00	25,000.00		35,000.00		92,765.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe Z	6	68,716.00	20,000.00	2,000.00	140,000.00	450,000.00	680,716.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	85,806.00	55,000.00		140,000.00	700,000.00	980,806.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	20	154,881.00	20,000.00	10,000.00		1,500,000.00	1,684,881.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe	17	157,439.00	100,000.00				257,439.00
730	Shëndetësia dhe Mirë	361	3,896,672.00	640,693.00	80,000.00	130,000.00	290,000.00	5,037,365.00
73025	Administrata	6	58,000.00	10,000.00				68,000.00
73950	Shërbimet e Shëndetë	355	3,838,672.00	630,693.00	80,000.00	130,000.00	290,000.00	4,969,365.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	111,339.00	30,000.00	8,000.00	10,000.00	190,000.00	349,339.00
	Shërbimet Rezidencia	6	50,000.00	45,000.00	5,000.00		430,000.00	530,000.00
850	Kultura, Rinia dhe Spo	49	418,056.00	137,000.00	70,000.00	230,000.00	396,000.00	1,251,056.00
85016	Shërbimet Kulturore	26	190,000.00	100,000.00	65,000.00	170,000.00	386,000.00	911,000.00
85056	Përkrahja e rinisë	1	11,113.00	10,000.00		20,000.00	10,000.00	51,113.00
85175	Teatri	22	216,943.00	27,000.00	5,000.00	40,000.00		288,943.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1552	12,413,168.00	1,411,625.00	303,500.00	70,000.00	715,000.00	14,913,293.00
92080	Administrata	11	110,000.00	700,000.00	50,000.00	70,000.00	405,000.00	1,335,000.00
92510	Arsimi parashkollor	120	910,000.00	220,000.00	40,000.00			1,170,000.00
93450	Arsimi fillor	1101	8,851,168.00	261,325.00	105,000.00		262,000.00	9,479,493.00
94650	Arsimi i mesëm	320	2,542,000.00	230,300.00	108,500.00		48,000.00	2,928,800.00

TOTAL KÉRKESAT

2285

19,297,938.00

4,670,000.00

788,500.00

1,085,000.00

14,742,931.00

40,584,369.00



Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2026

Kodi	Programet	Nr. Pun.	2024 Paga dhe shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	16	136,557.00	110,000.00		320,000.00		566,557.00
163/16316	Aministrata dhe Person	56	395,077.00	520,000.00	70,000.00			985,077.00
166/16631	Inspektimet	23	238,126.00	120,000.00				358,126.00
167/16780	Prokurimi	6	52,450.00	10,000.00				62,450.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Komun	39	317,640.00	32,000.00				349,640.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	30	223,619.00	50,000.00			666,072.00	939,691.00
180/18016	Shërbimet Publike - Infr	7	62,596.00	1,120,000.00	232,483.00	10,000.00	600,000.00	2,025,079.00
	Infrastruktura Rrugore	8	71,660.00	170,000.00			10,320,000.00	10,561,660.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspekt	55	411,371.00	110,000.00	20,000.00		270,000.00	811,371.00
195/19580	Zyra Komunale për Kon	4	32,765.00	25,000.00		40,000.00		97,765.00
470/47016	Bujësi, Pylltari dhe Zhv	6	68,716.00	20,000.00	2,000.00	144,625.00	500,000.00	735,341.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	85,806.00	55,000.00		144,625.00	450,000.00	735,431.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	20	154,881.00	20,000.00	10,000.00		1,200,000.00	1,384,881.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe N	17	157,439.00	110,000.00				267,439.00
730	Shëndetësia dhe Mirëq	361	4,166,672.00	650,693.00	90,000.00	150,000.00	220,000.00	5,277,365.00
73025	Administrata	6	58,000.00	10,000.00				68,000.00
73950	Shërbimet e Shëndetësi	355	4,108,672.00	640,693.00	90,000.00	150,000.00	220,000.00	5,209,365.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	111,339.00	30,000.00	8,000.00	15,000.00		164,339.00
	Shërbimet Rezidenciale	6	50,000.00	45,000.00	5,000.00		410,000.00	510,000.00
850	Kultura, Rinia dhe Sport	49	418,056.00	144,082.00	73,000.00	245,000.00	410,000.00	1,290,138.00
85016	Shërbimet Kulture	26	190,000.00	106,571.00	68,000.00	180,000.00	210,000.00	754,571.00
85056	Përkrahja e rinisë	1	11,113.00	10,000.00		20,000.00	200,000.00	241,113.00
85175	Teatri	22	216,943.00	27,511.00	5,000.00	45,000.00		294,454.00
920	Arsimi dhe Shkenc	1552	13,204,554.00	1,421,625.00	313,500.00	70,000.00	530,000.00	15,539,679.00
92080	Administrata	11	120,000.00	700,000.00	60,000.00	70,000.00	430,000.00	1,380,000.00
92510	Arsimi parashkollor	120	900,000.00	220,000.00	40,000.00			1,160,000.00
93450	Arsimi fillor	1101	9,642,554.00	261,325.00	105,000.00		70,000.00	10,078,879.00
94650	Arsimi i mesëm	320	2,542,000.00	240,300.00	108,500.00		30,000.00	2,920,800.00
	TOTAL	2285	20,359,324.00	4,763,400.00	823,983.00	1,139,250.00	15,576,072.00	42,662,029.00



Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2027

Kodi	Programet	Nr. Pun.	Paga dhe shitesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	16	136,557.00	116,350.00		320,000.00		572,907.00
163/16316	Aministrata dhe Person	56	395,077.00	540,000.00	70,000.00			1,005,077.00
166/16631	Inspektimet	23	238,126.00	120,000.00				358,126.00
167/16780	Prokurimi	6	52,450.00	10,000.00				62,450.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Komun	39	317,640.00	33,000.00				350,640.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	30	223,619.00	50,000.00			6,776,172.00	7,049,791.00
180/18016	Shërbimet Publike - Infr	7	62,596.00	1,120,000.00	264,682.00	10,000.00	600,000.00	2,057,278.00
	Infrastruktura Rrugore	8	71,660.00	150,000.00			5,530,000.00	5,751,660.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspekt	55	411,371.00	100,000.00	20,000.00		250,000.00	781,371.00
195/19580	Zyra Komunale për Kon	4	32,765.00	25,000.00		40,000.00		97,765.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe Zhv	6	68,716.00	20,000.00	2,000.00	160,000.00	520,000.00	770,716.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	85,806.00	55,000.00		160,000.00	250,000.00	550,806.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	20	154,881.00	20,000.00	10,000.00		1,000,000.00	1,184,881.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe N	17	157,439.00	110,000.00				267,439.00
730	Shëndetësia dhe Mirëqë	361	4,496,672.00	745,693.00	95,000.00	180,000.00	20,000.00	5,537,365.00
73025	Administrata	6	58,000.00	10,000.00				68,000.00
73950	Shërbimet e Shëndetësi	355	4,438,672.00	735,693.00	95,000.00	180,000.00	20,000.00	5,469,365.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	111,339.00	30,000.00	8,000.00	20,000.00		169,339.00
	Shërbimet Rezidenciale	6	50,000.00	45,000.00	5,000.00		410,000.00	510,000.00
850	Kultura, Rinia dhe Sport	49	418,056.00	147,000.00	77,000.00	270,390.00	250,000.00	1,162,446.00
85016	Shërbimet Kulturore	26	190,000.00	100,000.00	67,294.00	203,390.00	250,000.00	810,684.00
85056	Përkrahja e rinisë	1	11,113.00	10,000.00		20,000.00		41,113.00
85175	Teatri	22	216,943.00	37,000.00	9,706.00	47,000.00		310,649.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1552	13,953,598.00	1,421,625.00	313,500.00	70,000.00	760,000.00	16,518,723.00
92080	Administrata	11	120,000.00	700,000.00	60,000.00	70,000.00	730,000.00	1,680,000.00
92510	Arsimi parashkollor	120	900,000.00	220,000.00	40,000.00			1,160,000.00
93450	Arsimi fillor	1101	10,391,598.00	261,325.00	105,000.00			10,757,923.00
94650	Arsimi i mesëm	320	2,542,000.00	240,300.00	108,500.00		30,000.00	2,920,800.00
TOTAL		2285	21,438,368.00	4,858,668.00	865,182.00	1,230,390.00	16,366,172.00	44,758,780.00




GJAKOVA

KOMUNA E GJAKOVËS

Paga dhe	19,297,938.00	47.55%
Mallra dhe	4,670,000.00	11.51%
Shpenzime	788,500.00	1.94%
Subvencione	1,085,000.00	2.67%
Investime	14,742,931.00	36.33%
TOTALI	40,584,369.00	100.00%

Stuktura e buxhetit për vitin 2025





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



BUXHETIMI I PËRGJEGJSHËM GJINOR (BPGJ) 2025

Komuna e Gjakovës ka pasur në fokus të vazhdueshëm edhe parashikimin dhe shpenzimet e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ), dhe atë sipas praktikave më të mira, të femrave dhe meshkujve, djemve dhe vajzave në mënyrë që të kontribuohet në efektivitetin dhe transparencën e menaxhimit të financave publike duke bërë të dukshëm efektet e shpenzimeve publike.

Çfarë është Buxhetimi i Përgjithshëm Gjinor ?

